



Prishtinë: 01.03.2013

Kodi i ZRRE-së: V_513_2013

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_866_10_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_866_10_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 10.01.2013.

Në mbledhjen e mbajtur më 01 mars 2013 nxorri këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.Q. (shifra në KEK: DPR - 270125), nga Prishtina si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_866_10_12 i datës 01.10.2012.

Arsyetim

Me datë 13.02.2002 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për pranimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë bërë pranimin e njehsorit elektrike nr. 17740937.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 25.10.2007 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se kanë bllobuar njehsori elektrik nr. 17740937 me bllobbë distributive nr. A10039069 si dhe kanë theksuar se në qoftëse këputet bllobba distributive do të konsiderohet keqpërdorim i energjisë elektrike. Pas kësaj punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 24.03.2008 kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 17740937 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 40862878. Në vërtetimin e ndërrimit të njehsorit elektrik punëtorët e KEK-ut po ashtu kanë theksuar se bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik mekanik me atë elektronik.

Punëtorët e qendrës së kalibrimit me datë 22.10.2008 kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 17740937 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik bllobbat shtetërore i ka të falsifikuara, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka dhe se sistemi i fazës së parë (R) dhe fazës së tretë (T) janë të eliminuara dhe se për regjistrin më pak energji për 66.66%. Pas parashtrimit të ankesës në Departamentin për Konsumator në KEK me datë 07.09.2012 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e kalibrimit të datës 09.03.2009.

Pas këtij konstatimi të bërë nga punëtorët e qendrës së Kalibrimit, Departamenti për Faturim me datë 06.02.2009 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, fatura DPR09HP07278 në vlerë prej 1508.65€.

Konsumatori me datë 24.02.2009 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar. Departamenti për Konsumator në KEK e ka refuzuar ankesën e konsumatorit duke u thirrur në procesverbalin e kalibrimit dhe kontrollës.



Konsumatori me datë 20.03.2009 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës së dhe me datë 01.10.2012 ka nxjerr vendim duke **refuzuar pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që: **1)** të shkarkojë konsumatorin nga me shifër DPR - 270125 nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthim i humbjeve) DPR09HP07278 të datës 06.02.2009 në vlerë prej 1,508.65 €, **2)** të rikalkulojë faturën e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve) për periudhën 04/2007 – 03/2008, por duke marrë për bazë që shpenzimit të kësaj periudhe t'i shtohen edhe dy faza tjera.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 10.01.2013 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është për faktin se DMK, gjatë vendosjes së kësaj lënde ka bërë gabimisht vlerësimin e provave dhe shkresave të lëndës pasi që si DMK dhe KEK kanë konstatuar se ka pasur keqpërdorim të energjisë elektrike dhe se llogaritja e faturë duhet të bëhet sipas procedurës (siç e ka llogaritur KEK-u) e jo sipas vendimit të DMK-së. Po ashtu KEK-u në ankesë ka theksuar se DMK ka bërë shkelje të nenit 11 të procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Pra KEK-u në ankesën e tij drejtuar Bordit të ZRRE-së ka theksuar se është pajtuar me konstatimin e keqpërdorimit të bërë nga DMK por jo me mënyrën e llogaritjes së faturës së rikthimit të humbjeve.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 01 mars 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka analizuar të gjitha procesverbalet e inspektimit të KEK-ut dhe gjatë analizimit të tyre ka vërejtur se në procesverbalin e KEK-ut nr. 020050 të datës 25.10.2007 punëtorët e KEK-ut kanë bërë vulosjen (bllobimin) e njehsorit elektrik nr. 17740937 me vulë distributive A10039069, pasi që paraprakisht ka munguar vula distributive. Ndërsa me datë 24.03.2008 punëtorët e KEK-ut kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 17740937 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 40862878. Gjatë këtij ndërrimi të njehsorit elektrik punëtorët e KEK-ut kanë evidentuar vetëm se ndërrimi i njehsorit elektrik ka ndodhur nga ai mekanik në atë elektronik, por jo edhe se kemi edhe sisteme të fazës të eliminuara.

Bordi i ZRRE-së po ashtu ka analizuar edhe procesverbalin e qendrës së kalibrimin dhe konstatimet e dhëna në atë procesverbal se bllobat shtetërore i ka të falsifikuara, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka dhe se sistemi i fazës së parë (R) dhe fazës së tretë (T) janë të eliminuara dhe se për regjistrin më pak energji për 66.66%. Po ashtu janë analizuar edhe fotografitë e qendrës së kalibrimin të njehsorit elektrik nr. 17740937 ku shihen se dy sisteme të fazave janë të këputura.

Është analizuar edhe shpenzimi i energjisë elektrik i konsumatorit para dhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik dhe se sipas kësaj analize vërehet e mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin elektrike 12 muaj para ndërrimit të njehsorit elektrik ka qenë 185 kWh/muaj, ndërsa 12 muaj pas ndërrimit të njehsorit elektrik ka qenë 156 kWh/muaj.

Gjithashtu duke analizuar listat e leximit të KEK-ut, shihet se lexuesi i KEK-ut, në listën e leximit të periudhës 05/2007 nuk ka evidentuar asgjë të njehsori elektrik, e as të blloba distributive; lexuesi i KEK-ut në periudhën 06/2007 ka evidentuar se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 17740937 është në rregull, por mungon blloba distributive; lexuesi i KEK-ut në periudhën 07/2007 ka evidentuar se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 17740937 është në rregull, por mungon blloba distributive; lexuesi i KEK-ut në listat e leximit në periudhës 09/2007 ka evidentuar se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 17740937 është në rregull, por mungon blloba distributive; lexuesi i KEK-ut në listën e leximit të periudhës 10/2007 ka evidentuar se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 17740937 është në rregull, por mungon blloba distributive; lexuesi i KEK-ut në listën e leximit të periudhës



11/2007 ka evidentuar se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 17740937 është në rregull si dhe ka vulën distributive në rregull.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të këtyre procesverbaleve të KEK-ut ku edhe gjatë inspektimit të pikës matëse, vërtetimit të ndërrimit të njehsorit elektrik si dhe listave të leximit ka vërejtur se në asnjërën prej këtyre procesverbaleve KEK-u nuk ka arritur të konstatojë saktë gjendjen e njehsorit elektrik dhe se tek në procesverbalin e kalibrimit ka konstatuar se kemi dy faza të eliminuara. Po ashtu duke u nisur nga fakti gjatë analizës së shpenzimit të energjisë elektrike sipas viteve është vërejtur se nga viti në vit kemi rënie të shpenzimit të energjisë elektrik dhe se kjo është vërejtur edhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik ku në krahasim me njehsorin paraprak prapë ka pasur rënie të shpenzimit.

Bordi i ZRRE-së konsideron se DMK ka vepruar konform dispozitave ligjore, në rastin e aprovimit të ankesës së konsumatorit A.Q. me të cilën ka kërkuar nga KEK-u që: 1) të shkarkojë konsumatorin nga me shifër DPR - 270125 nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthim i humbjeve) DPR09HP07278 të datës 06.02.2009 në vlerë prej 1,508.65 €, 2) të rikalkuloj faturën e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve) për periudhën 04/2007 – 03/2008, por duke marrë për bazë që shpenzimit të kësaj periudhe t'i shtohen edhe dy faza tjera. Procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike është procedurë e aprovuar nga Bordi i ZRRE-se dhe se sipas kësaj procedure përveç tjerash tentohet që të bëhet llogaritja sa më e saktë e faturës së rikthimit të humbjeve.

Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 01.03.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_860_09_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar